



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS SPANJOLLE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë Praktike e Gjuhës B (1)

Ngarkesa: 12 kredite; 120 orë mësimore seminar

Viti / Semestri: Viti I, semestri I

Lloji i lëndës : Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit : Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Hispanik

Kodi i etikës : Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Ky kurs synon: Studenti të jetë i aftë të ndërveprojë përmes kompetencës komunikuese që ofron Niveli A (1,2) i përshkruar në MCERL (Manuali i referencës per gjuhët e huaja).

Objektivat specifike lëndore:

1. Të zhvillojë aftësinë për të përvetësuar koncepte bazike të gramatikës, dretshkrimit, drejtshqiptimit, fjalorit; aftësinë për të dialoguar me persona; Të njihet me zakonet dhe traditat në harkun kulturor hispanik; do të zhvillojë aftësinë e të punuarit në grup;
2. Të zhvillojë aftësinë kreative, do të arsyetojë në mënyrë kritike dhe auto-kritike;
3. Të zhvillojë aftësinë për të organizuar, planifikuar dhe përcjellë informacionin në auditor;
4. Të zhvillojë aftësinë për të vlerësuar dhe vetvlerësuar; për të rrefyer dhe recituar; për të konsultuar informacionin në web duke zgjeruar linjën e njohjeve përmes gjuhës se huaj;
5. Të zhvillojë aftësinë për t'u familiarizuar me përdorimin e teknikave dhe pasurive gjuhësore në procesin e të mësuarit dhe të të nxënit; gjithashtu edhe zhvillim i aftësisë vendimmarrëse;

Rezultatet e pritshme:

Studenti të jetë i aftë të përvetësojë koncepte bazike të gramatikës, drejtshkrimit dhe drejtshqiptimit, të fjalorit. Të shprehë në formë gojore dhe të shkruar konceptet thelbësore në gjuhën spanjolle; të përshkruajë vende dhe njerëz; të redaktojë një biografi; të kryejë komente të shkurtra mbi tema të ndryshme; të punojë në grup; të organizojë, planifikojë dhe përdorë informacionin në gjuhë të huaj; të njohë traditat dhe kulturën e popujve hispanikë; të vetvlerësohet dhe të vlerësojë të tjerët.